



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	151/17
Nr. i fq. / Br. sht	
Data: / Datum	14.02.2017
VUSHTRRI - VUČITRN	



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria për Prokurim- Komuna e Vushtrrisë

Vendi i punës: Përkthyes i gjuhës angleze

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj, pa mundësi vazhdimi)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 407.55 bruto

Qëllimi i vendit të punës:

Përkthimi i shkresave në Drejtorinë e Prokurimit dhe Drejtoritë tjera;

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

- Bën përkthimin e shkresave nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas;
- Bën përkthimin simultan sipas nevojës për organet e komunës);

Kualifikimi profesional, aftësitë, përgjegjësitë:

Diplomë universitare nga lëmi: Gjuhë dhe Letërsi Angleze ose njohës i mirë i gjuhës angleze;

Njohje shumë e mirë në të shkruar dhe në të folur;

Përvojë e preferuar në përkthim;

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimet ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimet. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, Certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime . Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. 028-572-416.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku